



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Komunikim Ndërkulturor

Ngarkesa: 4 kredite, 30 orë leksione, 10 orë seminar

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të ketë njohuri paraprake të teorisë së komunikimit dhe aspekteve kulturore të vendeve gjermanishtfolëse. Kjo është një lëndë me detyrim dhe me karakter formues gjuhësor që synon rritjen e kompetencës ndërkulturore në gjuhën B si dhe rritjen e aftësisë së studentëve për punë të pavarur në përballje me të huajën në situata të ndryshme ndërkulturore.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Studentët trajtojnë dy nocione komplekse: **kulturën** dhe **komunikimin**, si dhe arrijten e të kuptuarit ndërmjet përfaqësuesve të kulturave të ndryshme.
- 2.Studentët mësojnë të **sillen dhe të komunikojnë në mënyrë efektive** në vendet gjermanishtfolëse gjatë takimeve të ndryshme ndërkulturore.
- 3..Studentët **përftojnë dhe analizojnë** një vizion integruar të **komunikimit ndërkulturor**.
- 4.Studentët **ndërgjegjësohen për rëndësinë** që ka komunikimi ndërkulturor në shoqërinë e sotme.

Rezultate të pritshme:

Aftësia për të zhvilluar kompetencën e përgjithshme komunikuese në gjuhën B dhe asaj ndërkulturore për të komunikuar në mënyrë sa më efektive me njerëzit e kulturave të ndryshme.Aftësia për të zhvilluar mendimin analitik, kritik, logjik nëpërmjet përballjes me situata të ndryshme ndërkulturore gjatë procesit të komunikimit në gjuhën B.

Publiku i synuar: studentët në Master, drejtimi mesuesi